

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“DIAMOND CORPORATION AL-2024”

Kavaje me, 10.07.2024

Ortakët themelues:

- 1. DIAMOND CORPORATION SRL** shoqeri e huaj me kod fiskal dhe numer regjistrimi 05441370268, me perfaqesues ligjor Z. Ilir Tabaku.

NENI 1

Emri

- 1.1 Shoqëria tregtare mban emrin **“DIAMOND CORPORATION AL-2024” SHPK**.
- 1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

NENI 2

Forma

- 2.1 Shoqëria tregtare **“DIAMOND CORPORATION AL-2024”**, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (SHPK).

NENI 3

Zyra Qendrore

- 3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar **“DIAMOND CORPORATION AL-2024” SHPK** do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën: Durrës, zona kadastrale 8512, numer pasurie 22/593/ND-N8, Lagjia 2, Rruga Aleksander Goga.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

- 4.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në blerje, shitje, këmbim, rinovim i pasurive të paluajtshme të çdo natyre, si dhe vetqera (me kusht jofinanciare) e administrimin e pronave mbi të cilat shoqëria, në çfarëdo çilesie, ka në pronësi.

NENI 5

Kohëzgjatja

- 5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë **“DIAMOND CORPORATION AL-2024”** do të jetë me afat të pacaktuar.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit



6.1 Shoqëria tregtare “DIAMOND CORPORATION AL-2024” SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

7.1 Ortakët nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë “DIAMOND CORPORATION AL-2024” SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “DIAMOND CORPORATION AL-2024” SHPK është 100.000 (njqind mije) lekë.

8.2 Ortakët e shoqërisë janë:

1. **DIAMOND CORPORATION SRL** është zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 100% të kapitalit të shoqërisë, pra 100.000 leke.

NENI 9

Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.


NENI 10

Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Ortakë e Shoqërisë. Afati i emërimit është 5 (Pese) vjet. Kompetencat e administratorit përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë është **Z. Ilir Tabaku** lindur ne Durres dhe banues ne Oderzo, Itali, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i kartes me numer CA99939LE.

Ky Akt Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore.



ORTAKËT
E SHOQERISË ME PERGJEGJESI TË KUFIZUAR
“DIAMOND CORPORATION AL-2024”

DIAMOND CORPORATION SRL
(Perfaqesuar nga presidenti) Ilir Tabaku

A handwritten signature in black ink, consisting of several overlapping loops and a horizontal line extending to the right, positioned below the text of the representative.